



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 7468 Prot. datë 02.12.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

Nr. 14425 Prot. datë 22.11.2024

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 587, datë 02.12.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 661, DATË 01.12.2023 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZHVILLIMIN E MATURËS SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".

URDHËROJMË:

- Në rregulloren "Për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e urdhrit të përbashkët nr. 661, datë 01.12.2023 "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
 - Në nenin 2, pas pikës 1 dhe pikës 14 të shtohen përkatësisht pikat 1/1 dhe 14/1 me përmbajtje si më poshtë:

"1/1. *Ministria Përgjegjëse për AFP (Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Formimin Profesional).*

...

14/1. *QBNND (Qendra Burimore e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë)*".
 - Kudo në rregullore fjalët "Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar" dhe akronimi "DPAP" të zëvendësohen me fjalët "Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar" dhe "AKAP".

3. Pika 13. e nenit 6 të riformulohet si vijon:
"13. Informon çdo ZVAP për rezultatet e provimeve të Maturës së maturantëve/kandidatëve të shkollave përkatëse, si dhe institucionet e arsimit profesional".
4. Në pikat 4 dhe 5, të nenit 7 fjalët "...dhe në DRAP..." zëvendësohen me fjalët "...në DRAP dhe në institucionet e arsimit profesional..."
5. Shkronja "e", e nenit 8, ndryshon si më poshtë:
"e) monitoron të gjithë procesin e plotësimit të formularëve A1/A1Z, të cilët shkarkohen nga sistemi dhe nënshkruhen nga drejtori i shkollës, mbikqyrësi i formularëve dhe mësuesi kujdestar përkatës. Listën e maturantëve që kanë plotësuar këta formularë (në dy kopje), ia përcjell zyrtarisht ZVAP-it."
6. Në nenin 9 të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:
- a. *Titulli i nenit ndryshon si më poshtë:
 "Detyrat e Ministrisë përgjegjëse për AFP-në, ASCAP-it, AKAFPK-së, AKAP-it dhe DRAP-it"*.
 - b. *Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:
 1/1. Ministria përgjegjëse për AFP-në ka për detyrë të përgatisë listën e të gjitha shkollave të mesme të arsimit profesional dhe ta dërgojë në AKAP.*
 - c. *Në fund të pikës 2, shtohet fjalia si më poshtë:
 AKAFPK-ja përditëson listën e provimeve të detyruara të Teorisë Profesionale të Integruar sipas kualifikimit profesional që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale.*
 - d. *Pas shkronjës "b" të pikës 3, të nenit 9 shtohet shkronja "c" me përmbajtje si më poshtë:
 " c) Të dërgojë zyrtarisht në QSHA brenda muajit nëntor dhe elektronikisht listën dhe emërtimet zyrtare të shkollave të arsimit të mesëm të lartë, për Maturën Shtetërore dhe Maturën Shtetërore Profesionale."*
7. Në nenin 27, të shtohet pika 6/1 me përmbajtje si vijon:
"6/1. AKAP dërgon listën përfundimtare të maturantëve/kandidatëve që do i nënshtrohen rivlerësimit, në format elektronik në QSHA brenda datës 5 korrik".
8. Pas nenit 31, të shtohet neni 31/1 me përmbajtje si vijon:

"Neni 31/1

Provimet e Maturës Shtetërore për nxënësit e Qendrës Burimore të Nxënësve që Nuk Dëgjojnë

1. Maturanti/kandidati, i cili ka përfunduar me sukses vitin e fundit të shkollës së mesme të orientuar në QBNND dhe ka plotësuar formularin A1 dhe A1Z i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore.
 2. Testet e provimeve të Maturës Shtetërore hartohen nga QSHA në bashkëpunim me QBNND, bazuar në programet orientuese mësimore dhe fondin e pyetjeve të lëndëve përkatëse.
 3. Provimet e Maturës Shtetërore për këta maturantë zhvillohen në mjediset e QBNND, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, ku të jenë të primishëm edhe mësues të gjuhës së shenjave.
 4. Testi përmban të tre nivelet e arritjeve.
 5. Vlerësimi i testeve bëhet në bashkëpunim me mësuesit e QBNND.”
- II. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretarët e Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Institucionet Arsimore Parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

MINISTËR
OGERTA MANASTIRLIU



MINISTËR
BLENDI GONXHIA

